

AKTI THEMELIMI I SHOQËRISË
"SHPELLA VAJZE HITAJ" sh.p.k

mbështetje të Ligjit Nr.9901, datë 14.4.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", vendosa hartimin e këtij Akti themelimi, me kushtet që përcaktohen si më poshtë:

Sot ne date 28.10.2022, ortaket e shoqerise:

Z. ÇLIRIM HITAJ i datëlindjes 28/11/1974 shtetas Shqiptar, lindur në Sevaster mbajtës i dokumentit kartë identiteti me nr. Personal H41128030Q.

Z. TAULANT HITAJ i datëlindjes 29/04/1986 shtetas Shqiptar, lindur në Vajze, Vlore mbajtës i dokumentit kartë identiteti me nr. Personal I60429055Q.

Z. LEONARD HITAJ i datëlindjes 05/08/1976 shtetas Shqiptar, lindur në Sevaster, Vlore mbajtës i dokumentit kartë identiteti me nr. Personal H60805044H.

me vullnetin e tyre te lire dhe te plote, te shprehur nepermjet ketij akti themelimi, vendosi per krijimin e shoqerise tregtare " **SHPELLA VAJZE HITAJ**" Shpk me kushtet e meposhteme:

Neni 1

EMERTIMI

Shoqeria Tregtare do te ketë Emërtimin "**SHPELLA VAJZE HITAJ**" Shpk.

Neni 2

FORMA JURIDIKE

Shoqëria Tregtare " **SHPELLA VAJZE HITAJ**" Shpk, themelohet si Shoqëri Tregtare me Përgjegjësi të Kufizuar sh.p.k. Shoqëria është Person Juridik Privat Shqipëtar. Shoqëria krijohet në bazë të Ligjit nr.9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", ku ne nenin 3 përcaktohet se:

1. *Shoqëritë tregtare themelohen nga dy ose më shumë persona fizikë dhe/ose juridikë, që bien dakord për arritjen e objektivave ekonomike të përbashkët, duke dhënë kontribute në shoqëri, sipas përcaktimeve në statutin e saj. Shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar dhe shoqëritë aksionare mund të themelohen edhe vetëm nga një person fizik dhe/ose juridik (shoqëritë me ortak apo aksionar të vetëm).*
2. *Shoqëritë tregtare duhet të regjistrohen sipas nenit 22 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", si dhe neneve në vijim, sipas formës përkatëse të shoqërisë tregtare.*
3. *Shoqëritë tregtare fitojnë personalitetin juridik në datën kur kryhet regjistrimi i tyre në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit. Shoqëritë përgjigjen me të gjitha aktivet e tyre për detyrimet, që rrjedhin nga veprimtaritë e ushtruara."*

Neni 3

KOHEZGJATJA

Kohëzgjatja e shoqërisë " **SHPELLA VAJZE HITAJ**" Sh.p.k do te vazhdoje veprimtarine e saj me një afat kohor te pakufizuar.

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund të behet ne cdo kohe :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të ortakeve të shoqerise;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";
- d) me vendim të gjykatës;

Ne kete rast Ortaket e shoqerise marrin vendim me shkrim ne të cilin parashikojne menyren e likuidimit të shoqerise, duke



aktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtese “Shoqeri ne likuidim e siper”.

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket e shoqërise.

Nëse Ortaket e shoqërise nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t’i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

**Neni 4
SELIA**

Shoqëria Tregtare “SHEPELLA VAJZE HITAJ” Sh.p.k ndodhet ne Vajze, Rruga Rurale Vajze – Ploçe, Km 1, Lagjia e Çobanajve, Objekti Nr. 1.

Shoqëria mund te ndryshoje seline e saj, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijojë filiale, si brenda ashtu edhe jashte Republikës se Shqipërisë, vetëm me vendim te Ortakeve te Shoqërise.

Neni 5

OBJEKTI I VEPRIMTARISE SE SHOQERISE

Shoqëria ka si objekt te veprimtarise se saj :

--Perpunim dhe Tregeti me pakice dhe shumice bulmetore, Transport, Import, Eksport, Bar Restorant, etj.

Neni 6

KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar i shoqërise eshte i perbere nga kontributi i ortakeve themelues me vleren 100 000 lekë dhe perbehet nga tre kuota:

- ÇLIRIM HITAJ me kuote 34 %
- TAULANT HITAJ me kuote 33 %
- LEONARD HITAJ me kuote 33 %

Neni 7

TRANSFERIMI I KUOTEVE

Kuotat e kapitalit jane lirisht te Transferueshme ndermjet Ortakeve. Ortaku qe kerkon te shese kuoten e tij nje personi te trete, duhet detyrimisht tu njoftoj ortakeve te shoqërise blerjen e kuotave te tij ne te njejtat kushte si personit te trete te cilit ai deshiron t’ia shese. Kur disa ortake ushtrojne te drejten e tyre te parablerjes dhe shprehin deshiren e tyre per te blere kuoten, ortaku shites gezon te drejten diskrecionale per te zgjedhur se cilit ortak ai deshiron ti shese totalisht ose pjeserisht kuotat e tij. Ortaket duhet te pergjigjen brenda 30 diteve nese deshirojne te blejne kuotat e ofruara apo jo.

Neni 8

SHPERNDARJA E FITIMIT

Ortaket financojne, perfitojne rimbursim te financimit te tyre dhe ndajne fitimin e tyre ne baze te kuotave ne kapitalin themeltare.

Neni 9

ORGANET DREJTUESE TE SHOQERISE

Organet Drejtuese te Shoqërisë janë :

- 1.Administratori,
- 2.Asamblea e Pergjithshme e Zakonshme ose e Jashtezakonshme e Ortakeve.

Aministratori i Shoqërisë është Z. ÇLIRIM HITAJ i datëlindjes 28/11/1974 shtetas Shqiptar, lindur në Sevaster mbajtës i dokumentit kartë identiteti me nr. Personal H41128030Q.

Neni 10

KOMPETENCAT E ADMNISTRATORIT

Administrator ushtron kompetenca ne emer te Shoqërise:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;

LEONARD HITAJ
Çlirim Hitaj

- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- d) përgatis dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- e) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- f) kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- g) raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- a) sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim dhe
- b) kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara,
- c) Administratori ka të drejte të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaja, autoriteteve shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkalleve. Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakeve të shoqërisë.
- d) Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Neni 11

Veprimtaria ekonomike dhe financiare e shoqërisë ndahet në periudha financiare 12 mujore. Viti financiar fillon nga data 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor të cdo viti kalendarik, me përjashtim të vitit të parë i cili fillon nga data e krijimit të shoqërisë dhe mbaron me 31 Dhjetor.

Neni 12

Shoqëria mban dokumentacionin e nevojshëm financiar për administrimin e pasurisë dhe për zhvillimin e të gjithë veprimtarisë së saj, në përputhje me kërkesat e të gjithë legjisllacionit përkatës në fuqi. Bilanci financiar i shoqërisë përfitohet në baze të raportit me shkrim të eksperteve kontabel të autorizuar dhe të raportit të paraqitur nga administratorët brenda datës 31 mars të vitit pasardhës. Të dy raportet paraqiten me miratohen në asamblene e ortakeve brenda datës 30 qershor. Fitimi neto i shoqërisë llogaritet mbasi zbriten humbjet e mundshme të vitit të mëparshëm, shlyerja e të gjitha detyrimeve fiskale dhe ndaj cdo personi të tretë, si dhe fondet financiare që perbejne rezervën e detyrueshëm.

Neni 13

ZGJIDHJA E MOSMARRREVESHJEVE

Mosmarrveshjet lidhur me themelimin dhe zhvillimin e veprimtarisë së shoqërisë zgjidhen nga vete ortakët e shoqërisë me mirekuptim, dhe kur kjo nuk arrihet ato zgjidhen nga gjykata në territorin e se ciles ndodhet selia e shoqërisë.

ORTAKET E SHOQËRISË "SHEPELLA VAJZE HITAJ" Sh.P.K

- ÇLIRIM HITAJ
- TAULANT HITAJ
- LEONARD HITAJ

Çlirim Hitaj
Taulant Hitaj
Leonard Hitaj

STATUTI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“SHELLA VAJZE HITAJ”

KREU I
THEMELIMI, EMRI ,OBJEKTI,KOHËZGJATJA,SELIA.

NENI I
DATA E THEMELIT, THEMELUESIT DHE EMRI

- 1 - Sot me datën 28/10/2022 ne themeluesit kemi krijuar një shoqëri me pergjegjësi të kufizuar me emrin **SHELLA VAJZE HITAJ**.
- 2 –Themeluesi të shoqërisë janë :

Z. ÇLIRIM HITAJ i datëlindjes 28/11/1974 shtetas Shqiptar, lindur në Sevaster mbajtës i dokumentit kartë identiteti me nr. Personal H41128030Q.

Z. TAULANT HITAJ i datëlindjes 29/04/1986 shtetas Shqiptar, lindur në Vajze, Vlore mbajtës i dokumentit kartë identiteti me nr. Personal I60429055Q.

Z. LEONARD HITAJ i datëlindjes 05/08/1976 shtetas Shqiptar, lindur në Sevaster, Vlore mbajtës i dokumentit kartë identiteti me nr. Personal H60805044H.

NENI 2
OBJEKTI I VEPRIMTARISË

--Perpunim dhe Tregeti me pakice dhe shumice bulmetore, Transport, Import, Eksport, Bar Restorant, etj.

TË TJERA

(brenda kuadrit te dispozitave ligjore shoqëria ka të drejtë të shtojë aktivitetet e nevojshme në listë dhe të kryej çdo biznes të përshtatshëm për arritjen e qëllimit të saj)

NENI 3
KOHËZGJATJA

Kohëzgjatja e shoqërisë **SHELLA VAJZE HITAJ SH.P.K.**, është pa afat.

NENI 4
SELIA

Selia e Shoqërisë **SHELLA VAJZE HITAJ SH.P.K.**, ndodhet në adresën ndodhet ne Vajze, Rruga Rurale Vajze – Ploçe, Km 1, Lagjia e Çobanajve, Objekti Nr. 1.

NENI 5
EMRAT E REGJISTRUAR DHE EMËRTIMET TREGTARE

Shoqëria bazuar në Ligjin 9901 datë 14.04.2008 "Per tregtarët dhe shoqëritë tregtare" (i ndryshuar) neni 4 , pika 2 etij ; do të përdorë dhe emërtime tregtare, si dhe shenja të tjera dalluese të veprimtarisë duke i regjistruar këto në përputhje me ligjin nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit “ apo çdo ligj tjetër të posaçëm.

Kreu II
KAPITALI
NENI 6
KAPITALI THEMELTAR

- Kapitali themeltar i shoqërise është i perbere nga kontributi i ortakëve themelues me vlerën 100,000 lekë. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributin e tyre financiar si më poshtë:

-Ortakët themelues zotërojnë gjithsej 100% të kuotave dhe perbehet nga 3 (tre) kuota si më poshtë:

- ÇLIRIM HITAJ me kuote 34 %
- TAULANT HITAJ me kuote 33 %
- LEONARD HITAJ me kuote 33 %

NENI 7

ZMADHIMI DHE ZVOGËLIMI I KAPITALIT THEMELTAR

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e nje eksperti te autorizuar per keto kontribute sipas kërkesës së administratorit.

Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

NENI 8

TRANSFERIMI I KAPITALIT

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe ne statut.

Sanksionohet se, në rast të kalimit të kuotave me shitje apo dhurim të drejtën e parablerjes fillimisht e kanë ortakët ekzistues të shoqërisë.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

NENI 9

ORGANI VENDIMMARRËS

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarres i shoqërise që miraton cdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të percaktuara në ligj.

Asambleja e përgjithshme e ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Leonard Hitaj

Çlirim Hitaj

Taulant Hitaj

Ortakë mund të përfaqësohet në asamblenë, e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.
Administratori i shoqërisë nuk mund të vepronë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

NENI 10

MËNYRA E THIRRJES SË MBLËDHJES SË ASAMBLËSË SË PËRGJITHSHME

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë në adresën personale të deklaruar prej ortakut të cituar në statut dhe në rast ndryshimi të saj, në adresën e re të paraqitur pranë shoqërisë. Nnjëkohësisht do të kryhet dhe njoftimi nëpërmjet postës elektronike në adresën e sipërcituar dhe në rast ndryshimi të saj, në adresën e re të paraqitur pranë shoqërisë.

Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime.

NENI 11

KUORUMI

Në rastin e marrjes së vendimeve të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse në të marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 70 për qind të kuotave.

Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit "Për Tregëtarët dhe Shoqëritë Tregtare", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se me më shumë se të katërtat e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur më lart, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

NENI 12

MARRJA E VENDIMEVE

Asambleja e përgjithshme vendos me më shumë se të katërtat të votave të zoteruesve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme vendos me mbi tre të katërtat e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si:

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- ç) përcaktimin e shpërblimeve
- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Cdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKB për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

NENI 13

PËRJASHTIMI NGA E DREJTA E VOTËS

1.Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:

- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
- b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
- c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
- ç) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.

2.Kur ortakë përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortakë, të cilin përfaqëson.

NENI 14
ADMINISTRIMI

- (1) Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
- (2) Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.
- (3) **Aministrator i Shoqërisë është Z. ÇLIRIM HITAJ** i datëlindjes 28/11/1974 shtetas Shqiptar, lindur në Sevaster mbajtës i dokumentit kartë identiteti me nr. Personal H41128030Q, **me një mandat 5-vjeçar nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Bisnesit.**

NENI 15
KOMPETENCAT E ADMINISTRATORIT

Administratorët ka të drejtë dhe detyrim të

- a) kryej të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqëson shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatiti dhe nënshkruaj bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqet këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryej regjistrimet dhe dërgojë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;
- e) raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- ë) kryej detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Administratori është i/e detyruar të thërrasi Asamblenë e Përgjithshme, në rastet kur:

- sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezultojnë ose ekzistojnë rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
- shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
- shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë. Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të cilësuar referuar nenit 12 të statutit.

Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

NENI 16
PËRGJEGJËSITË E ADMINISTRATORIT

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Per Tregëtarët dhe Shoqëritë Tregëtare", administratori detyrohet:

1. a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;
- b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;

...vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
...të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezant apo të mundshëm, të interesave personale
me ata të shoqërisë;

d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregëtare", kryen veprimet e mëposhtme:

a) u kthen ortakëve kontributet;

b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;

c) u shpërndan aktivet shoqërisë;

ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;

d) jep kredi.

Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit gjatë ushtrimit të detyrës.

KREU IV VITI FINANCIAR-EKSPERTËT

NENI 17 VITI FINANCIAR

Viti financiar i Shoqërisë fillon më 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor. Përjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe mbyllet më 31 Dhjetor.

NENI 18 EKSPERTËT

-Eksperti referuar kërkesave të legjislacionit në fuqi ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomiko tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollin periodik të ushtruar prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e ortakëve.

-Ne perfundim të kontrollit eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për rezultatin e bilancit financiar vjetor si dhe për atë për kontrollin periodik të ushtruar, të cilat është i detyruar që t'ja paraqesë e dorëzojë në kohë ortakëve për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

KREU V PRISHJA –RIORGANIZIMI I SHOQËRISË

NENI 19 PRISHJA DHE LIKUIDIMI

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë :

a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;

b) me vendim të Asamblesë së Ortakëve;

c) me hapjen e procedurave të falimentimit;

ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit";

d) me vendim të gjykatës;

...kete rast Ortaket merrin vendim me shkrim ne të cilin parashikojne menyren e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1(një) apo disa likuidatore dhe shënuar në çdo dokument të nxjerrë prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë " Shoqëri në likuidim e sipër". Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit të gërdhjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi. Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket. Nëse Ortaket nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

NENI 20
RIORGANIZMI I SHOQËRISË BASHKIMI-NDARJA

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendim të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare."

NENI 21
BAZA LIGJORE

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar. Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

NENI 22
MOSMARRËVESHJET

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, kompetente do të jetë Gjykata Shqiptare.

ORTAKET
E SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

* SHPELLA VAJZE HITAJ * SH.P.K.

- ÇLIRIM HITAJ
- TAULANT HITAJ
- LEONARD HITAJ

Glirim Hitaj
Taulant Hitaj
LEONARD HITAJ